Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0846

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) MEDIATECH & PRINT SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të Komunës Ferizaj në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit 'Furnizimi me printer për Komunën e Ferizajt" me numër të prokurimit 656-23-9797-1-2-1, me 15/12/2023, mori:

Vendim

1.Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa e OE MEDIATECH & PRINT SH.P.K. me nr. 2023/0846, e datës 28/10/2023, kurse vendimi i AK KOMUNA FERIZAJ lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me printer për Komunën e Ferizajt" me numër të prokurimit 656-23-9797-1-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim.**

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik MEDIATECH & PRINT SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 13.09.2023, KOMUNA FERIZAJ në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me printer për Komunën e Ferizajt" me numër të prokurimit 656-23-9797-1-2-1. Ndërsa me datën 16.10.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me te cilin ka shpërblyer me kontrate OE DataProgNet SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 50,000.00 €.

Me 19.10.2023, OE MEDIATECH & PRINT SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 20.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 28.10.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE MEDIATECH & PRINT SH.P.K me nr. 846/23 lidhur me aktivitetin "Furnizimi me printer për Komunën e Ferizajt me numër të prokurimit 656-23-9797-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues MEDIATECH & PRINT SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) Ankuesi pretendon se: "Autoriteti Kontraktues ne vendimin e datës 16.10.2023 e ka theksuar si arsyetim te eliminimit te Kompanisë sonë qe ne si OE nuk kemi dërguar ISO IEC 20000 – 1 2018 , ne ju informojmë se vete AK-ja me datën 22.09.2023 ka bere ndryshimin me formularin B54 formulari për përmirësimin e gabimeve dhe ne këtë formular nuk ka figuruar fare kjo iso e kërkuar dhe gjate kërkesës sonë për sqarim te dërguar me date 26.09.2023 ne kemi kërkuar informata shtese qe te korrigjoni dosjen e tenderit përsëri dhe ti vendosni kriteret e njëjta si ne Formular ashtu edhe ne dosje, sepse ne baze te LPP-se Formulari B54 për përmirësimin e gabimeve është final dhe aty qka ceken kritere ashtu duhet te dorëzohen nga OE sepse sipas ligjit ky formular është final sepse aty behën te gjitha ndryshimet te dosjes se tenderit."

Pretendimi i dyte (II) Ankuesi pretendon se: "Gjithashtu ne me date 16.10.2023 kemi kërkuar qasje ne dokumente për ti shikuar gjithë dokumentacionin e këtij OE Fitues te shpallur nga ju, ne kemi ardhur ne qasje me date 17.10.2023 por kemi hasur ne shume pa rregulluesi sepse neve nuk na u është lejuar marrja e tere dokumentacionit te këtij OE FITUES ne baze te ligjit ne fuqi. Zyrtari nga AK na ka ofruar një dokument "Kërkesa për sekret afarist" te përpiluar nga OE Fituese por dokumentet te cilat ky OE i ka etiketuar si sekret afarist nuk qëndrojnë dhe nuk janë konform Ligjit te LPP-se sepse sekrete afariste duhen te jene 7.5 Informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë: a. informacionet në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP-se , pra nuk mund te jene sekret afarist një ISO STANDARD , nuk mund te jete një sekret afarist stafi i kompanisë, dhe nuk mund te jene sekrete afariste projektet e realizuara sepse gjitha këto dokumente janë te hapura dhe publike për palën e tret te interesit sepse këto mjafte lehte me një kërkim te thjesht mund te verifikohen. Këtë OE Fitues e ka bere me qellim apo me tendence sepse ne tani nuk jemi te sigurt a ka qene ky OE me te vërtet i përgjegjshëm kur nuk argumenton dhe dokumenton këto dokumente por ky me

qellim kërkon ti fsheh këto dokumente te cilat nuk janë sekrete afariste për palët me interes."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE MEDIATECH & PRINT SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 11, 59, 60 dhe 72 të LPP dhe shkeljet e nenit 7 dhe 41 të Rregullores për Prokurim Publik duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

AK në vendimin ndaj kerkeses per rishqyrtim të datës 20.10.2023 ka refuzuar si te pabazuara pretendimet ankimore kurse ka rekomandur qe te mbetet ne fuqi vendimi per dhenie i datës 12.10.2023.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 03/11/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 846/23, ndërsa me datë 16/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0846 me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rishqyrtim"

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE MEDIATECH & PRINT SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0846 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) ankimor është i pabazuar pasi që "Eksperti shqyrtues sqaron se AK, me datën 21/09/2023 ka publikuar formularin B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, përmes të cilit ka bërë disa ndryshime, ndër të tjera duke larguar nga kriteret teknike dhe profesionale, dy nga certifikatat për ISO standarde, të kërkuara përmes Njoftimit për kontratë, të publikuar më 13/09/2023. Në këtë formular të gabimeve të korrigjuara janë përfshirë përmirësime vetëm për ato kritere të cilat janë ndryshuar apo larguar tërësisht si kritere për aktivitetin e prokurimit, ndërsa pjesa tjetër e cila nuk është përfshirë në formularin e korrigjimeve, mbetet e njëjtë si në Njoftimin e parë për Kontratë. OE ankues pretendon që është eliminuar padrejtësisht për faktin që nuk ka dorëzuar me ofertë certifikatën ISO IEC 20000-1 2018, për shkak se e njëjta nuk është përfshirë në formularin e korrigjimeve të gabimeve në njoftimin për kontratë. Eksperti pasqyron që një kërkesë e tillë për ISO standard, ka qenë e përfshirë edhe në Njoftimin e parë për kontratë edhe tek kriteret në Dosje të Tenderit, përderisa kjo kërkesë përmes Formularit B54 as nuk është larguar dhe as nuk është ndryshuar, e njëjta nuk

është përfshirë fare në njoftimin e dytë, që do të thotë që vazhdon të mbetet e njëjtë si në njoftimin e parë. Për më tepër, kur kjo ka qenë një kërkesë e Dosjes së Tenderit është më se e qartë që është dashur të merrej parasysh nga ana e OE ankues. AK sipas nenit 72 të LPP-së, ka kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues që të dëshmoj posedimin e certifikatës ISO IEC 20000-2018, por OE ankues edhe pas kësaj kërkese nuk e ka ofruar të njëjtën. Andaj arsyetimi i OE ankues se është eliminuar padrejtësisht është i pabazuar.''

Pretendimi i dytë (II) ankimor është i bazuar pasi qe "OE ankues pas kërkesës së bërë për të pasur qasje në ofertën e OE i rekomanduar, ka marr përgjigje nga AK se OE i rekomanduar ka plotësuar Aneksin 3 përmes të cilit, të gjitha dokumentet e ofertës, përfshirë Dokumentacionin e kërkuar, Stafin e Kompanisë dhe Projektet e realizuara me vlera, është kërkuar që të qëndrojnë sekret afarist dhe të mos shpërndahen tek palët e treta. Përkatësisht, sipas Ankesi 3, e tërë oferta e OE i rekomanduar është kërkuar që të mbetet sekret afarist. Sipas ekspertit shqyrtues jo të gjitha dokumentet në një ofertë mund të cilësohen si sekret afarist, sipas nenit 11 të Ligjit për Prokurimin Publik, ky nen thotë që AK duhet të përgatitë një version të pastruar, përmes të cilit AK duhet të bëjë ndarje se cilat të dhëna mund të konsiderohen si sekrete afariste dhe cilat jo. Duke u bazuar edhe në nenin 7 të Rregullores për Prokurimin Publik, përkatësisht pika 7.6, b thotë se: Nëse Operatori Ekonomik konsideron që informatat e dorëzuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së të trajtohen nga Autoriteti Kontraktues si informata sekrete afariste në përputhje me nenin 11 të LPP-së, i njëjti duhet të shkarkojë nga sistemi Aneksin 3 "Kërkesa për sekret afarist", të plotësojë duke dhënë arsyetimet për secilin dokument të identifikuar si "sekret afarist", nënshkruaj dhe vulos aneksin, si dhe ta ngarkojë në sistem së bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij. Po ashtu neni 7 i RRPP-së, pika 7.3 po ashtu thotë se: Pas publikimit të rezultatit mbi vendimin e AK vetëm informatat e klasifikuara nga OE dhe të pranuara nga AK si sekrete të biznesit do të mbesin sekrete për të gjitha palët duke përjashtuar KRPP, OSHP, përfshirë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues dhe gjykatat kompetente. Pra, sipas Legjislacionit në fuqi, dokumentet të cilat deklarohen si sekrete afariste nga ana e Operatorëve Ekonomik, të njëjtat cilësohen të tilla vetëm pasi të jenë të pranuara si sekrete afariste edhe nga ana e Autoritetit Kontraktues. Nga kjo çfarë u sqarua më lartë, eksperti vlerëson që AK duhet të krijoj një version të pastruar të dokumenteve, sekret afarist duhet të mbesin të gjitha ato dokumente apo të dhëna për të cilat edhe vet AK është bindur se me të vërtetë, shpërndarja e tyre tek operatorët e tjerë, mund të shkaktojnë çfarëdo dëmi për OE i rekomanduar, por sekret nuk mund të cilësohet secili dokument i ofertës dhe secila e dhënë. AK, duhet të lejoj OE ankues të ketë qasje në dokumentet përkatëse, ashtu siç e lejon edhe ligji në fuqi. Andaj, nga kjo çfarë u sqarua më lart vlerësojmë që ky pretendim i ngritur nga OE ankues është **i bazuar.**

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues MEDIATECH & PRINT SH.P.K Argumentimi në raportin e ekspertit është i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues MEDIATECH & PRINT SH.P.K janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas

të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna Ferizaj të datës 16.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me printer për Komunën e Ferizajt" me numër të prokurimit 656-23-9797-1-2-1, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim. Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP, pasi jo çdo dokument i ofertës dhe secila e dhënë AK do të trajtohet/cilësohet si sekret. AK do duhej të krijoj një version të pastruar të dokumenteve, sekret afarist duhej të mbesin të gjitha ato dokumente apo të dhëna për të cilat edhe vet AK është bindur se me të vërtetë, shpërndarja e tyre tek operatorët e tjerë, mund të shkaktojnë çfarëdo dëmi për OE e rekomanduar. Pra, në rastin në fjalë, OE ankues do duhej të kishte qasje në dokumentet përkatëse, ashtu siç është parapare me dispozitat ligjore. Nga ana tjetër edhe vetë AK me datën 21.11.2023 ka deklaruar se pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues se kjo lëndë të kthehet në **Rivlersim.**

Sa i përket ofertës së OE ankues i njëjti sipas raportit të ekspertit dhe kosntatimit të bërë nga ana e komisionit vlerësues brenda AK, rezulton i papërgjegjshëm për këtë aktivitet, sepse nuk i ka përmbushur kërkesat e DT-së, pasi që AK përmes nenit 72 kishte kërkuar sqarime shtesë për certifikatën ISO gjatë procedurës paraprake, sepse kjo kërkesë sie till kishte mbetuar e pandryshuar nga AK në NJK dhe DT, kurse

Ankuesi nuk e kishte dorëzuar atë sipas kërkesës së AK.

Përfundimisht pas administrimit të provave vërehet se AK nuk ka vepruar sipas nenit 11 të LPP-së, ku sipas dispozite së cituar është dashur të ofroj një version të pastruar të ofertës së OE i rekomanduar, andaj meqenëse edhe vet AK është pajtuar që kjo procedurë të kthehet në rivlersim për të gjith ofertuesit, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së. Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si me sipër.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Lidhur me tarifën ankimore është vendosur konform nenit 31 paragrafi 4 dhe paragrafi 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA FERIZAJ**
- OE - **MEDIATECH & PRINT SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: